

Shenimet per Pasqyrat Financiare per vitin e mbyllur me 31.12.2019

1. Informacion i Pergjithshem:

"UFO" Sh.p.k, eshte themeluar si nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me Vendim Nr.4392 , date 24.05.1994 te Gjykates se Rrethit Tirane. Selia e shoqerise eshte ne Bulevardin Zogu i Pare , Ish-Pallati I Kultures " Ali Klemendi " Tirane. Kapitali i Rregjistruar i shoqerise eshte 460.000.000 leke dhe zoterohet 100 % nga Ortaku Z.Astrit Veliaj .

Veprimtaria kryesore shoqerise eshte Aktiviteti ne fushen e Arsimit te Larte.

Permbledhje e politikave kontabel

Bazat e pergatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare te vitit 2019 janë pergatitur në te gjitha aspektet ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Kontabilitetit (SNK) dhe ligjin Nr.9228 date 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" , i ndryshuar . Pasqyrat Financiare jane pergatitur ne monedhen vendase, Lekë Shqiptar (lekë).

Parimet kontabile më domethënëse që janë pëdorur nga shoqëria, janë si më poshtë:

Njohja e te ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara. Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri te mjaftushme ne marrjen e perfitimeve. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përlogaritet me besueshmëri. Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatat e ofruara. Shpenzimet njihen atehere kur ato sigurohen prej te treteve dhe ne te njejtin ushtrim kontabel me te ardhura e lidhura.

Monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci, zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit të në datën e bilancit. Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj, maten në termat e kostos historike dhe nuk rivlerësohen. Fitimi ose humbja e pa realizuar nga ndryshimi i kurseve të këmbimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqëria për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2019 jane
1 Euro = 121.77 leke dhe 1 USD=108.64



Shenimet per Pasqyrat Financiare per vitin e mbyllur me 31.12.2019

Tatimin mbi fitimin

Shpenzimi per tatimin mbi fitimin perfaqeson shumen e tatimit per tu paguar per vitin ushtrimor. Tatim fitimi i pagueshem per vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshem i cili ndryshon nga fitimi tregetar qe raportohet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve, sepse korrektohet nga shpenzimet e panjohura sipas legjistacionit fiskal. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin per vitin ushtrimor 2019 eshte 15 %.

Kërkesat për t'u arkëtuar

Kërkesat për t'u arkëtuar, të ardhurat e konstatuara dhe llogari të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u arkëtuar në parë regjistrohen në bilanc me kosto të amortizuar. Kostoja e amortizuar e kërkesave për t'u arkëtuar afatshkurtra, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provizionet e krijuara për rënie në vlerë), kështu që kërkesat afatshkurtra regjistrohen në bilanc me vlerën e tyre neto të realizueshme (e cila raportohet, për shembull në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

Pasivet financiare

Huat e marra, furnitorët, shpenzimet e konstatuara dhe huamarrje të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u shlyer në parë, në përgjithësi, mbahen me koston e amortizuar në bilanc. Kostoja e amortizuar e pasiveve financiare afatshkurtra, në përgjithësi, është e barabartë me vlerën e tyre nominale; kështu që pasivet financiare afatshkurtra mbahen në bilanc në vlerën e tyre neto të realizueshme (për shembull, të raportuar në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

Aktivet e qëndrueshme të trupëzuara

Aktivet afatgjata materiale (AAM-të) bazohen ne modelin e koston. Në bilanc, një element i AAM-së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Amortizimi eshte llogaritur mbi bazen e metodes lineare per aktivet afatgjata Jo-materiale ,ndersa aktivet afatgjata materiale me bazen e vleren se mbetur per pjesen tjetere te aktiveve te qendrueshme. Normat e perdorura per AA Jo-materiale deri ne 15 % te vleres fillestare dhe per ndertesat deri ne 5 % ,pajisje informatike deri ne 25 % dhe aktivet e tjera deri ne 20% te vleres se mbetur.

Gjendjet e inventaret

Vleresimi ne hyrje i inventareve behet me cmimet e blerjes dhe ne rastet kur eshte e aplikueshme u shtohen kostot e shkaktuara per te sjelle inventaret ne kushte magazinimi. Gjendjet e inventarit ne pasqyrat financiare paraqiten me kostot e blerjeve te fundit te ushtrimit qe nga drejtimi eshte çmuar si vlera neto te realizueshme.



Shenimet per Pasqyrat Financiare per vitin e mbyllur me 31.12.2019

2- Shenimet qe shpjegojne zerat e bilancit .

1- Mjete monetare

Gjendjet e mjetet monetare ne banke dhe arke te koverturea ne leke ne datat 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018 jane si me poshte:

Emertimi i Llogarise	Monedha	Gjendja ne 31.12.2019 Ne leke	Gjendja ne 31.12.2018 Ne leke
Llogari bankare	LEK, EUR, USD	67,204,037	59,833,593
Arka ne leke	LEK, EUR,USD	11,642,154	5,494,854
Shuma		78,846,191	65,328,447

Gjendjet e llogarive konfirmohet me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike te monedhave. Tepricat e shprehura në monedhë të huaj, janë konvertuar në leke duke përdorur kursin e këmbimit të fundit të vitit sipas BSH i cili është : EURO =121.77 leke dhe USD =108.64

Shoqeria ka llogari rrjedhese ne Alfa Bank , Raiffesisen Bank , Union Bank , Societe Generale dhe FIB .

2. Te drejta te arketueshme afatshkurtra

Kerkesat , te drejta te arketueshme dhe aktive te tjera financiare, ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel te vitit 2019 deklarohen si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2018
Kliente	58,713,885	45,514,297
Kerkesa nga njesite ku ka interesa pjesemarrese	47,673,322	47,673,322
Te tjera te drejta e kerkesa	113,711,544	80,983,600
Shuma	220,098,751	174,171,220

Ne Llogarine "Kliente" jane pasqyruar shumat e paarkteuara te klienteve (studenteve) .

Ne kerkesa nga njesite ku ka interesa pjesemarrese , ne shumen prej 47.673.322 leke ka te beje me shoqerine Vokopola Energji ku shoqeria zoteron nje pjese te Kuotave te saj.

Llogarine " Te tjera te drejta dhe kerkesa " jane kerkesa ndaj "UTV Education " shpk ne shumen prej 80.682.774 leke, Tatimi fitimi paguar me teper ne shumen prej 6.968.551 leke , pjesa tjeter eshte Paradhenie personeli , paradhenie furnitori per blerje dhe mardhenie me doganat .

3. Shpenzime te shtyra .

Shpenzimet e shtyra ne vitin 2019 paraqiten si me poshte :

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2018
Shpenzime te shtyra	124,760,925	75,275,672
Vlera neto	124,760,925	75,275,672

Shpenzime te shtyra perfaqesojne shpenzime te veprimtarise qe u perkasin periudha te ardhshme .



Shenimet per Pasqyrat Financiare per vitin e mbyllur me 31.12.2019

4. Aktivet Afatgjata Materiale(AAM-te)

Gjendjet dhe levizjet e aktiveve afatgjata materiale ne pasqyrat financiare paraqitet si vijon:

Gjendjet dhe levizjet	Toka dhe Ndertesa dhe Aktive te Qerave	Pajisje zyre, Inf dhe tjera	Mjete Transporti	Totali
A Kosto e AAM-ve me 01.01.2019	4,099,985,433	623,760,342	76,420,504	4,800,166,280
Shtesat	208,215,965	52,478,815	-	260,694,780
Pakesimet	-	-	-	-
Kosto totale e AAM me 31.12.2019	4,308,201,398	676,239,157	76,420,504	5,060,861,060
B Amortizimi AAM-ve 01.01.2019	329,510,700	356,196,416	31,756,874	717,463,989
Amortizimi ushtrimit	146,083,523	55,287,889	8,932,726	210,304,138
Amortizimi per daljet e AAM-ve	-	-	-	-
Amortizimi i AAM-ve 31.12.2019	475,594,223	411,484,305	40,689,600	927,768,127
D Vlera neto e AAM-ve 01.01.2019	3,770,474,734	267,563,927	44,663,630	4,082,702,291
Vlera neto e AAM-ve 31.12.2019	3,832,607,176	264,754,853	35,730,904	4,133,092,932

Vlerat dhe klasifikimi ne grupe i AAM-ve te pasqyruara ne bilanc dhe ne tabelen e mesiperme jane te perputhura me te dhenat e kontabilitetit dhe te inventarizimeve fizike qe shoqeria e ka kryer ne fund te muajit Dhjetor 2019. Si politike kontabel per kontabilizimin dhe spjegimin e AAM-ve, shoqeria ka zgjedhur modelin e koston. Vleresimi fillestar ne momentin e marrjes ne inventar eshte bere me koston e marrjes dhe ne daten e mbylljes se bilancit paraqiten me koston e tyre minus amortizimin e akumuluar dhe ndonje humbje te akumuluar nga zhvleresimi. Ne AAM (Ndertesat) perfshihen edhe aktivet e qerave sipas IFRS 16 te llogaritura dhe amortizimi i tyre per vitin 2019

Aktivt e qerave me date 01.01.2019 jane 153.801.239 leke dhe amortizmi vjetor per 2019 eshte 61.499.548 leke. Vlera neto e aktiveve te qerave me 31.12.2019 eshte 92.301.690 leke .

Drejtimi mendon se pergjithesisht per kete ushtrim kontabel, nuk ka shenja te renies ne vlere te AAM-ve dhe nuk ka llogaritur zhvleresime.

5. Detyrime afatshkurtra:

Ne detyrimet afatshkurtra ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel te vitit 2019 paraqiten si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2018
Detyrime per kredi afatshkurter	101,166,067	244,343,280
Furnitore	10,556,637	13,703,126
Detyrime te Qerave	94,548,449	0
Sigurime Shoqerore dhe Shendetsore	7,020,837	7,779,655
TAP per tu paguar	3,827,908	1,927,683
Tatim ne Qera dhe ne Burim	6,181,356	2,545,912
TVSh per tu paguar	36,033	29,755
Debitore dhe kreditore te tjere	30,875,730	18,619,730
Personeli	2,610,606	26,730,308
Shuma	256,823,623	315,679,448

Shenimet per Pasqyrat Financiare per vitin e mbyllur me 31.12.2019

“Detyrime per kredi afat shkurter “ perqesojne “ Overdraftin” e mare ne Union Bank ne monedhen e Euro per nje periudhe shkurter .

“Furnitorëve” pasqyron detyrimet ndaj furnitoreve per blerjen e sherbimeve dhe mallrave pa u likjuar ne fund te ushtrimit. Shoqeria ka pergatitur inventaret kontabel dhe shuma e llogarise sintetike eshte e barabarte me shumen e llogarive analitike te mbajtura per cdo furnitor. Drejtimi mendon se te drejtat e furnitoreve jane te vleresuara realisht. “Sigurimet shoqerore dhe shendetsore , TAP dhe TVSH “ dhe Tatim ne Burim dhe te Personeli , jane detyrime te muajit Dhjetor 2019 te cilat jane paguar brenda Janar 2020.

6. Te ardhura te shtyra

Te ardhura e shtyra ne vitin 2019 paraqiten si me poshte :

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2018
Te ardhura te shtyra	140,680,429	143,759,383
Vlera neto	140,680,429	143,759,383

Te ardhurat e shtyra pasqyrojne jane shumen e tarifave te studenteve , te cilat jane paguar por si te ardhura u perkasin periudhave te vitit 2020 pasi nuk eshte kryer sherbimi i mesimdhënises .

7. Hua AfatGjata

Hua Afatgjata ne vitin 2019 paraqiten si me poshte :

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2018
Hua AfatGjata		
Hua ne banka	696,259,722	624,921,999
Vlera neto	696,259,722	624,921,999

Ne fund te vitit 2019 gjendja e principalit te kredive Afatgjata (ne Euro te konvertuara me kursin e kembimit prej leke /Euro) jane ne shumen prej 696.259.722 leke nga e cila :

- 120369.265 leke & 223.065.596 leke & 97.890.058 leke , kredi ne OTP Bank ne Euro .
- 85.239.000 leke & 169.695.803 leke , kredi ne Union Bank ne Euro .

8. Kapitalet e Veta

Kapitali i regjistruar i shoqerise i paraqitur ne bilanc , eshte i njejte me ate te percaktuar ne statutin e shoqerise dhe vendimet e depozituara ne QKR. Kapitali i nenshkruar eshte 460.000.000 leke , i ndare ne 100 kuota me vlere nominale 4.600.000 leke /kuota. Gjate ushtrimit kontabel te vitit 2019 nuk ka pasur ndryshime ne kapitalin themeltar. Totali i Kapitaleve te Veta te Shoqerise me 31.12.2019 eshte ne shumen prej 3.463.035.035 leke , i cili perbehet nga Kapitali i nenshkruar ne shumen prej 460.000.000 leke , Rezerva Ligjore 5.176.116 leke, Rezerva te tjera per Investime 2.847.940.684 leke dhe Fitimi neto i vitit financiar 2019 ne shumen prej 149.918.236 leke.

Shenimet per Pasqyrat Financiare per vitin e mbyllur me 31.12.2019

9. Fitimi (humbja) e vitit financiar

▪ Te ardhurat

Te ardhura e realizuara gjate ushtrimit, sipas segmenteve (kategorive) te biznesit paraqitet si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2018
Te ardhurat		
Te ardhura nga Arsimi	1,151,544,384	1,163,356,967
Te ardhura te tjera	20,466,140	19,606,620
Vlera neto	1,172,010,524	1,182,963,587

Të ardhurat nga "Shitja e Sherbimeve ne Arsim" jane te ardhurat nga studentet per mesimdhienien dhe "Te ardhurat e tjera" jane te ardhura nga Klinika Dentare , Bari dhe Shitja e Librave . Paraqitja ne pasqyrat financiare e te ardhurave dhe shpenzimeve eshte bere sipas Natyres se tyre. Veprimtaria e sherbimeve ne arsim eshte e perjashtuar nga TVSH-ja. Totali i shifres se afarizimit te Deklaruara ne FDP eshte 1.168.931.570 leke dhe ka nje diference prej 3.078.954 leke nga totali i te ardhurave sipas PASH , pasi gjate vitit 2019 kemi rimarrje ne te ardhurave te shtyra .

10. Shpenzimet e veprimtarise kryesore.

Shpenzimet kryesore te Veprimtarise per vitin 2019 dhe 2018 jane :

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2018
Shenzimet		
Kosto e Punes	404,992,049	424,381,675
Materiale te konsumuara	29,870,847	27,535,847
Shpenzime operative dhe administrative	319,783,030	428,756,411
Amortizimi	210,304,138	72,596,839
Shuma	964,950,064	953,270,772

"Kosto e punes " perfaqesojne pagat e personeli , sigurime shoqerore per pedagoget.

"Materialet e konsumuara " perfaqesojne materialet per kliniket dentare , barin, librarine dhe mesim dhenien ne Universitet .

"Shpenzimet e tjera " perfaqesojne shpenzimet per Qera 72.632.633 leke , Sherbime per mesimdhienien ne shumen 163.576.335 leke , Energji ,uje dhe Naftë 31.156.944 leke , Taksa lokale 11.387.738 leke, Reklama dhe Publicitet 19.222.703 leke, Riparime dhe Mirembajtje 9.176.118 etj.

" Amortizimi per ndertesat dhe aktivet e tjera eshte llogaritur me metoden e vleres se mbetur dhe eshte ne vleren prej 148.804.590 leke si dhe me amortizimi per aktivet e mara me qera sipas IFRS 16 ne shumen prej 61.499.548 leke .



Shenimet per Pasqyrat Financiare per vitin e mbyllur me 31.12.2019

11. Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Te ardhurave me shpenzimet financiare per vitin 2019 dhe 2018 jane si me poshte ;

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2018
Shpenzime nga Kurset e kembimit	-	-
Te Ardhura nga Kurset e kembimit	11,577,337	45,207,683
Shpenzime financiare per Interesa	(35,456,481)	(41,252,931)
Shpenzime per interesa te llogaritura per Qerate	(6,217,291)	
Shuma	(30,096,435)	3,954,752

Gjate vitit 2019 ka pasur shpenzime per interesa per te Huave dhe ardhura nga nga kurset e kembimit si rrjedhoje e luhatjeve te Euro-s nga 123.42 leke/Euro ne fillim te vitit ne 121.77 Leke /Euro ne fund te vitit. Bazuar ne IFRS 16 eshte llogaritur interesi per detyrimet e qerave qe eshte ne shumen prej 6.217.291 leke.

12. Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Shpenzimet e tatimi mbi fitimin per ushtrimin kontabel 2019 dhe 2018 jane si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2018
I FITIMI NETO PARA TATIMIT	176,964,025	233,647,567
II SHPENZIME TE PAZBRITESHME (+)	3,341,236	2,646,072
1 Amortizime tej normave fiskale	-	-
2 Shpezime pritje e dhurime tej kufirit tatimor	1,300,000	-
3 Gjoha,penalitetet dhe te Tjera te Panjohura	2,041,236	2,646,072
III PJESA E HUMBJES SE MBARTUR(-)	-	-
IV FITIMI (HUMBJA) TATIMORE(I+II-III)	180,305,261	236,293,639
V Shpenzimi i tatim fitimit-15%	27,045,789	35,444,046
VI FITIMI NETO I USHTRIMIT(I-V)	149,918,236	198,203,521

Tatim fitimi i ushtrimit eshte i llogaritur mbi fitimin e tatushem sipas legjislacionit fiskal, analizuar ne tabelen e mesiperme. Tatim fitimi i paguar gjate vitit 2019 eshte ne shumen prej 34.351.354 leke dhe ne 31.12.2019 gjendja e tatimit te fitimit te mbipaguar eshte 6.372.971 Leke.


3- Ngjarjet pas dates se bilancit dhe vazhdimesia e shfrytezimit

Ngjarje te ndodhura pas dates se miratimit te pasqyrave financiare nuk ka . Gabime materiale te ndodhura ne periudhat e meparshme kontabel, te kostatuara gjate periudhes raportuese nuk ka.

Per Drejtimin e Njesise Ekonomike

Hartoi
()



()
(Administrator)